



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 2271 Prot.

Shkodër me 31.03 2026

V E N D I M

Nr. 10, datë 27.03.2026

PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Z. Refik Ali Vorfa

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 27.03.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin “Propozim për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror”, të përgatitur nga administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”; si dhe kërkesën e subjektit

Pasi u kalua në proces votimi të fshehtë nga anëtarët e Këshillit të Qarkut, **ku u miratua me: 15 vota Pro, 0 vota Kundër dhe 0 vota Absenim;**

V E N D O S I:

I. T’i propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror për:

Z. Refik Ali Vorfa

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr.139/2015



KRYETARI

Edmond NDOU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

№. 227/2 Prot.

Shkodër më 31.03 2026

RELACION

PROJEKT - VENDIM

PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 27.03.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin "Propozim për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror", të përgatitur nga administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" me ndryshimet përkatëse, pensioni i posaçëm shtetëror apo shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror u takon: **b) Personave që kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës.**

Në përputhje me dispozitat ligjore të mësipërme, akteve nënligjore dalë në zbatim të tyre si dhe në kërkesën e paraqitur pranë Këshillit të Qarkut Shkodër paraqesim këtë relacion për shqyrtim të mëtejshëm, propozim për dhënie të shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror, për:

Z. Refik Ali Vorfa

- lindur në Shkodër 02.02.1952
- përfiton aktualisht një pension mujor pleqërie prej 37.689 (Tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, përfitues që me datë 09.02.2017.
- Mban Titullin " Mjeshtër sporti", dhënë nga Komiteti i Këshillit të Përgjithshëm të Bashkimit të Fiskulturistëve dhe Sportistëve të Shqipërisë, me datë 28.01.1989.
- I është akorduar "Medalje e Artë" - Për merita në fushën e sportit, nga Ministria Kulturës, Rinisë dhe Sportit, datë 11.05.2001.
- Mban Titullin "Mjeshtër i Madh", akorduar nga Presidenti i Republikës me dekret 11096, datë 22.02.2019.

Duke shpresuar në miratimin nga ana Juaj,



KRYETARI

Edmond NDOU